



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT NË FUSHËN E SIGURISË
USHQIMORE, VETERINARISË, MBROJTJES SË BIMËVE DHE PESHKIMIT**

Nr. 6552/1 prot.

Tiranë, më 7 . 10 .2024

U R D H Ë R

Nr. 792, datë 7 . 10 .2024

PËR

**NJOHJEN E ORGANIZATËS TË MBIKQYRJES TË PESHKIMIT "LAGUNA
KARAVASTA" SI ORGANIZATE E MENAXHIMIT TË PESHKIMIT (OMP)**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të Ligjit Nr. 90, datë 27.9.2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", nenit 62 të Ligjit nr. 64/2012 "Për Peshkimin", i ndryshuar dhe Rregullores "Për përcaktimin e procedurës dhe kushteve shtesë për njohjen e organizatave të menaxhimit të peshkimit", e miratuar me Urdhrin e Ministrit nr. 702, date 12.09.2024,

URDHEROJ:

1. Njohjen e Organizatës të Mbikëqyrjes të Peshkimit "Laguna Karavasta" si një OMP të ligjshme për menaxhimin e burimeve të peshkimit në zonën bashkëmenaxhuese "Laguna e Karavastasë", e shpallur me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 238, date 23/04/2014.
2. OMP-ja është e autorizuar të ushtrojë funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara nga Ligji nr. 64/2012 dhe Rregullorja e miratuar.
3. Ministria do të kryejë kontrolle periodike për të verifikuar respektimin nga ana e OMP-së të kushteve të njohjes dhe zbatimin e planit të bashkëmenaxhimit, i cili do të miratohet nga Ministri pasi OMP ta këtë përgatitur në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për peshkimin.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për njoftimin e këtij Urdhri Organizatës të Mbikëqyrjes të Peshkimit “Laguna Karavasta”, me seli në Divjakë, për publikimin e këtij Urdhri në faqen zyrtare të ministrisë, si dhe për regjistrimin e Organizatës të Mbikëqyrjes të Peshkimit “Laguna Karavasta” në regjistrin e organizatave të peshkimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
ANILA DENAJ

